



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-059

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 03/L-034 PËR
SHTETËSINË E KOSOVËS**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 03/L-034
PËR SHTETËSINË E KOSOVËS**

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 26 (02.06.2008).

Neni 2

Neni 1 i ligjit bazik, në rreshtin e parë pas fjalës “**fitim**” i shtohet fjala “**rifitim**”.

Neni 3

Neni 2 i ligjit i ligjit bazik, pas përkufizimit “**fëmijë**” i shtohet edhe një përkufizim i ri si vijon:

g) Personi i pa-shtetësi (apatrid) - nënkupton personin i cili nuk konsiderohet shtetas i asnjë shteti në kuadër të fushëveprimit të ligjit të shtetit përkatës.

Neni 4

1. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 7.1. në rreshtin e dytë pas fjalës **“panjohur”** i shtohet togfjalëshi **“ose pa shtetësi”**.
2. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 7.3. në rreshtin e dytë fshihet togfjalëshi **“leje qëndrim të vlefshëm”**, dhe ndryshohet dhe plotësohet me togfjalëshin **“leje qëndrim të përhershëm”**.

Neni 5

Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 10.1. pika b) riformulohet si vijon:

- b). të qëndroj pesë (5) vjet në Republikën e Kosovës pas marrjes së leje qëndrimit të përhershëm.

Neni 6

Pas nenit 12 të ligjit bazik, shtohet një nen i ri 12A si vijon:

Neni 12A

Fitimi i shtetësisë i personit pa shtetësi-apatrid

12A1. Personi pa shtetësi mund ta fitoj shtetësinë e Kosovës nëse qëndron në territorin e Kosovës pesë (5) vite pa ndërprerje, me leje qëndrimi të përhershëm.

12A2. Të drejtën e fitimit të shtetësisë së Kosovës e kanë edhe fëmijët e personit nga paragrafi 1 i këtij neni. Për fëmijët mbi moshën katërbëdhjetë (14) vjeçare deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, pëlqimi paraprak i tij për të fituar shtetësinë e Kosovës është i domosdoshëm.

12A3. Kriteret për fitimin e shtetësisë Kosovës në bazë të këtij neni, caktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga MPB-ja;

Neni 7

Neni 18 i ligjit bazik paragrafi 18.1. riformulohet si vijon:

18.1. Fëmija nën moshën katërbëdhjetë (14) vjeçare e humbë shtetësinë e Kosovës me lirim, nëse kjo kërkohet nga njëri prind i cili e ka humbë shtetësinë e Kosovës me lirim me pëlqimin e prindit tjetër.

Neni 8

Neni 27 i ligjit bazik, paragrafi 27.1. riformulohet si vijon:

27.1. Taksa administrative caktohet me vendim nga ministri.

Neni 9 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-059
21 tetor 2011

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI